



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 10.2.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Murat Hoxha, Adem Salihaj, Shaip Muja.

Mungoi : Salih Salihu, Velimir Rakiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.1.2015 dhe 2.2.2015,
3. Shqyrtimi i procedurës për përzgjedhjen e kandidatit për kryesues të komisionit shqyrtues në Zyrën rregullatorë për ujësjellës dhe kanalizim,
4. Shqyrtimi i propozimeve për ekspertë rreth angazhimit në Projektligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Ujrave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.1.2015 dhe 2.2.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi pajtimin e komisionit për dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara.

3. Shqyrtimi i procedurës për përzgjedhjen e kandidatit për kryesues të komisionit shqyrtues në Zyrën rregullatorë për ujësjellës dhe kanalizim

Kryetari fillimisht dëshiroj mirëseardhje anëtarit të komisionit nga PDK z. Shaip Muja dhe vazhdoi me njoftimin që GP të premtën është takuar për të diskutuar rreth kësaj pike për çka ja dha fjalën kryesuesit. **Murat Hoxha** njoftoi komisionin se GP më 6.2.2015 debatoi bashkërisht me drejtorët Raif Preteni dhe Xheladin Hoxha mënyrën e përzgjedhjes së kandidatit për Kryesues të Komisionit Shqyrtues të ankesave në ZRRUK dhe vendosi të aplikoi praktikën e kaluar si vijon : 1. Të hartohen kriteret që duhet ti plotësoi kandidati përfshirë edhe kohëzgjatjen dhe mandatin, 2. Të shpallet konkursi nga ky komision dhe 3. Të përzgjidhet kandidati nga ana e komisionit, kandidatura e të cilit i dërgohet për miratim në Kuvend , ku edhe bëhet 4. votimi dhe miratimi. Ai shtoi se përgjegjësitë e kryesuesit i ka caktuar personalisht, çka do të thotë se mund të janë objekt diskutimi në komision. **Adem Salihaj** u pajtua për konkurs dhe ishte i mendimit se do të ishte mirë që nga kjo zyre rregullatorë të kërkohej rregulloret në mënyrë që të njoftohet ky komision më detalisht, ai shtoi se nuk ka nevojë të ceket që kandidati të mos jetë i dënuar më tepër se 6 muaj burg. **Murat Hoxha** u përgjigj se ky Kryesues i takon Kuvendit, ndaj edhe është aplikuar praktika e kaluar, ndërkaq **Haxhi Shala** tha mos është e tepërt edhe kërkesa për të pasur provimin e judikaturës, çka kryesuesi arsyetoi qëndrimin e tij me lidhmërinë me profesionin e juristit, si dhe modalitetin e pagesës nga Kuvendi e potencoi, i cili do të shikohet pasi të shpallet konkursi. Komisioni nxori :

V E N D I M

TË SHPALLET KONKURSI për vendin e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në ZYRËN RREGULLATORË PËR UJËSJELLES DHE KANALIZIM duke dërguar në Shërbimin e personelit të Kuvendit kriteret që u hartuan nga komisioni, me tekstin si vijon :

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall :

K O N K U R S

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Komisioni shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim.

Mandati i Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim zgjedhet për mandat tre (3) vjeçar.

Përgjegjësitë dhe kompetencat e Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim:

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim është përgjegjës për:

1. Pranimin dhe regjistrimin e ankesave, ndaj vendimeve të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim,
2. Koordinimin dhe bashkëpunimin me anëtarët e tjerë të Komisionit shqyrtues,
3. Zbatimin e drejtë të procedurave të shqyrtimit të ankesave të parashikuara me ligje dhe akte nënligjore,
4. Analizimin, shqyrtimin dhe procesimin e ankesave.

Kandidati për Kryesues të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- të ketë diplomë Universiteti katër (4) vjeçar ose master, drejtimi juridik,
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim
- të ketë integritet të lartë moral,
- të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale,
- të mos jetë në mardhënie pune në Kompanitë publike të licencuara nga Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

4. Shqyrtimi i propozimeve për ekspertë rreth angazhimit në Projektligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Ujrave të Ndotura dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë

Kryetari sugjeroi që në këtë takim të propozohen ekspertët për draftimin e ligjit në fjalë, ndërkaq më vonë komisioni do të mbledhë nga anëtarët e komisionit CV që propozohen për ekspert në këtë komision si nga fusha e mjedisit, ashtu edhe nga fusha e bujqësisë. Edhe lidhur me këtë pikë kryetari ja dha fjalën GP përkatësisht kryesuesit, në emër të së cilës **Murat Hoxha** tha se të premten janë diskutuar procedurat që duhet të zbatohen rreth këtij ligji : 1. Ligji i draftuar nga legjislacioni i kaluar të jetë objekt shqyrtimi dhe draftimi i këtij komisioni, 2. GP të ketë mbështetjen e ekspertëve nga fusha përkatëse, 3. Të organizohet debati me grupe të interesit, ekspertë, qytetarë-shoqëria civile, 4. Dërgimi i draftit final në Qeveri 5. Shqyrtimi final në komision, 6. Shqyrtimi në Kryesinë e Kuvendit dhe Grupet parlamentare, 7. Shqyrtimi i parë në Kuvend, 8. Shqyrtimi i amendamenteve, 9. Shqyrtimi i dytë dhe 10. Nënshkrimi nga Presidenti. Propozoi ekspertët Robert Muharemi (jurist) dhe Skender Bublakun (për hidro), ndërkaq për Baton Begollin si këshilltar nga Kryeministria ishte i mendimit që i njejtë nuk ishte për ndryshimin rrënjësor të ligjit të mëparshëm, derisa GP është i interesuar për një ligj të mirë. **Lahi Brahimaj** tha se nuk është mirë të kemi ekspert të cilët vijnë dy tri herë, pastaj mund të ndodhë që thojnë nuk po vijmë, sugjeroi që komisioni të zgjedhë këtë çështje. **Adem Salihaj** propozoi të ftohen edhe profesionistë të lëmisë nga MMPH, ndërsa **Kryetari** propozoi të gjitha këto aktivitete me ekspert të kryhen pas leximit të parë, por **Murat Hoxha** megjithatë sugjeroi një finalizim nga komisioni pas një puntorie që do të organizohej nga ky komision, pastaj të vazhdohet me procedimin e cekur nga kryetari. **Shaip Muja** tha se ekspertët ma mirë është të përzgjedhën me konkurs duke ofruar CV e tyre, në mënyrë që përgjegjësia e tyre të jetë më e lartë. **Haxhi Shala** ishte për procedim më të shpejt dhe kryerjen e këtyre punëve profesionale pas leximit të parë, mirëpo prapë **Murat Hoxha** insistoi në finalizim nga komisioni, ngase janë disa gabime jo aq të mëdha por megjithatë janë gabime të cilat duhet të eliminohen paraprakisht, pastaj të dërgohet në Qeveri. Komisioni nxori :

P E R F U N D I M

TË MBAHET PUNËTORIA më 16.2.2015 në orën 10,00 me grupet e interesit lidhur me draftimin e ligjit për ZRRUK.

Pas mbajtjes së punëtorisë Grupi punues do të mbledhet për finalizimin e draftit me mbështetjen e ekspertëve Robert Muharemi, Skender Bublaku dhe Baton Begolli.

Për punëtori të ftohen grupet e interesit dhe komisioni bashkërisht me ekspertët e cekur më lartë.

5. Të ndryshme

Kryetari hapi diskutimin rreth pikës të ndryshme ku u iniciuan disa çështje lidhur me cilësinë e ushqimit, miellit dhe ruajtjen e pyjeve me një dakordim që në mbledhjet e radhës të ftohen përfaqësuesit e agjencive përkatëse-përkatësisht kryeshefat e tyre. Fillimisht u kërkua që agjencitë në fjalë të dërgojnë njoftimet nga të cilat antarët e komisionit do të njoftohen me aktivitetet e tyre. Diskutuesit ishin **Lahi Brahimaj, Shaip Muja, Adem Salihaj.**

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka